



**RAPORTI VJETOR**  
**I**  
**INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË**  
**PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**  
**VITI 2021**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>HYRJE</b> .....	<b>2</b>
<b>1 ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR</b> .....	<b>4</b>
<b>1.1 REFORMA NË DREJTËSI DHE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E RI TË DREJTËSISË</b> .....	<b>4</b>
<b>1.2 ZBATIMI I LIGJIT NR. 9049/2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, I NDRYSHUAR DHE SISTEMI ELEKTRONIK I DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË</b> .....	<b>8</b>
<b>1.3 ZBATIMI I LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”, I NDRYSHUAR</b> .....	<b>9</b>
<b>2 TË DHËNA MBI DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATË</b> .....	<b>14</b>
<b>2.1 ADMINISTRIMI I DEKLARATAVE, SKANIMI, PËRPUNIMI PARAPRAK DHE KONTROLI ARITMETIK DHE LOGJIK</b> .....	<b>14</b>
<b>2.2 KONTROLI I PLOTË DHE REZULTATET E KONTROLLIT</b> .....	<b>15</b>
<b>3 ROLI PARANDALUES/NDËRGJEGJËSUES DHE BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL E NDËRKOMBËTAR</b> .....	<b>17</b>
<b>3.1 ROLI PARANDALUES DHE NDËRGJEGJËSUES</b> .....	<b>17</b>
<b>3.2 BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL E NDËRKOMBËTAR</b> .....	<b>18</b>
<b>4 REKOMANDIMET E GRUPIT TË SHTETEVE KUNDËR KORRUPSIONIT</b> ...	<b>20</b>
<b>5 PERFORMANCA FINANCIARE</b> .....	<b>23</b>
<b>6 TRANSPARENCA INSTITUCIONALE</b> .....	<b>26</b>
<b>7 PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE</b> .....	<b>26</b>
<b>8 PRIORITETET PËR VITIN 2022</b> .....	<b>28</b>
<b>ANEKSI NR. 1</b> .....	<b>30</b>

## HJRJE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi dhe zhvillimit të aktivitetit institucional, përgjatë vitit raportues, ka synuar përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në Rezolutën për vitin 2021.

Në këtë drejtim, Inspektorati i Lartë vijoi të mbështesë proceset për verifikimin e kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, si dhe të forcojë më tej bashkëpunimin me organet përkatëse të emërtesës, me qëllim përfundimin e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë. Për më tepër, në fokus të veçantë për periudhën e raportimit kanë qenë përmbushja e kompetencave të parashikuara nga Ligji nr.9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar, Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, si dhe nga Ligji nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, i ndryshuar.

Konkretisht, për t’u theksuar është angazhimi institucional në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga skema e kontrollit të subjekteve deklaruese, rritja e kapaciteteve investiguese, marrja dhe hetimi i rasteve të konfliktit të interesave dhe sinjalizimeve, brenda afateve ligjore të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi dhe Kodi i Procedurave Administrative.

Në këtë kuadër, Raporti Vjetor për vitin 2021 vjen si një dokument në të cilin, në mënyrë të plotë, paraqitet një analizë e masave të marra në drejtim të përmbushjes së rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, rekomandimeve të lëna nga organizatat ndërkombëtare, kompetencave ligjore, si dhe rezultateve të arritura.

Në lidhje me performancën institucionale gjatë vitit 2021, krahas paraqitjes në mënyrë të detajuar në Raportin Vjetor, të arritjeve dhe prioriteteve, Inspektorati i Lartë dëshiron të ritheksojë angazhimin në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese e ligjore, në vazhdimin e verifikimit të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë, forcimit të mëtejshëm të rolit institucional në përmirësimin e mekanizmave të kontrollit të deklaratave të interesave privatë, parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe në hetimin e rasteve të sinjalizimit e garantimin e mbrojtjes së sinjalizuesve.

## 1 ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR

### 1.1 REFORMA NË DREJTËSI DHE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E RI TË DREJTËSISË

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor për reformën në drejtësi, si dhe duke pasur në fokus rekomandimin e Kuvendit të Shqipërisë, të parashikuar në Rezolutën për vitin 2021: *“Të forcojë më tej bashkëpunimin e deritanishëm me institucionet e rivlerësimit dhe ONM-në deri në përfundim të procesit të rivlerësimit nga këto organe, si dhe të vijojë mbështetjen e proceseve për verifikimin e kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, në një kohë sa më të shpejtë”*, Inspektorati i Lartë ka vijuar mbështetjen e procesit reformues të sistemit të drejtësisë.

Në forcimin e bashkëpunimit me organet e rivlerësimit kalimtar dhe ONM, përgjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë ka trajtuar me përparësi më shumë se 155 kërkesa të ardhura, duke vendosur në dispozicion dokumentacionin shtesë të kërkuar nga organet e rivlerësimit, brenda afateve të përcaktuara nga këto organe.

Përveç trajtimit të kërkesave të ardhura nga organet e rivlerësimit, ILDKPKI në zbatim të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 76/2016 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar,

Ligjit nr. 97/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* i ndryshuar, ka administruar deklaratat e pasurisë dhe interesave private të kandidatëve për

pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe ka ushtruar kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare nga kandidatët dhe personat e lidhur me ta.

Përgjatë vitit 2021 është ushtruar kontrolli i plotë për deklaratat e pasurisë dhe interesave privatë, për rreth **312 kandidatë** në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, duke realizuar:

- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë **për 8 kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese** dhe dërgimin, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dosjen e kontrollit të plotë, për secilin kandidat, në format elektronik (CD), e cila përmban Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit, dokumentacionin e dorëzuar nga vetë kandidati, dokumentacionin e administruar nga korrespondenca me institucionet e specializuara, raportin përfundimtar të kontrollit, së bashku me konkluzionet përkatëse.
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, **për 1 kandidat për gjyqtar në Gjykatën e Lartë**, nga rradhët e gjyqtarëve dhe vendosi në dispozicion të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë, **për 82 kandidatë për hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit** dhe dërgimin, pranë Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës/Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, dosjen e plotë, e cila përfshin Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatëve, si dhe dokumentacionin e administruar, së bashku me konkluzionet përkatëse, në format elektronik (CD).
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë **për 1 kandidat për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** dhe

dërgimin, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor e aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë **për 18 kandidatë për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit** dhe dërgimin, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor e akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr.75, datë 23.5.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë për **35 kandidatë për pranim në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar**, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022 dhe dërgimin, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor e akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr.179, datë 3.6.2021 “Për fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatëve për t’u pranuar në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës”, përfundimin e kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë për **25 kandidatë për në formimin fillestar për magjistratë, profili prokuror**, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021 - 2022 dhe dërgimin, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë e akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr.8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë për **9 kandidatë për këshilltarë** pranë Njësisë Ligjore në **Gjykatën Kushtetuese** dhe dërgimin pranë Gjykatës

Kushtetuese të akteve përfundimtare të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.

- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, përfundimin e kontrollit të plotë për **30 kandidatë për kancelarë në detyrë** dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë të kandidatëve.
  
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe akteve nënligjore, përfundimin e kontrollit të plotë për **12 kandidatë për pranim në shërbimin civil gjyqësor, profili këshilltar ligjor dhe ndihmës ligjor** dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, e akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
  
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, përfundimin e kontrollit të plotë për **16 kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë, për në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës** dhe dërgimin pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, të akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
  
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore, përfundimin e kontrollit të plotë për **49 kandidatë për personel administrativ** të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe dërgimin, pranë Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës për Prokurorinë dhe Gjykatat e Posaçme, e akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.
  
- ✚ Në zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përfundimin e kontrollit të plotë për **26 kandidatë për drejtues prokurorie, të juridiksionit të përgjithshëm** dhe dërgimin pranë, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e akteve të përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë.



## 1.2 ZBATIMI I LIGJIT NR. 9049/2003 “PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE, TË DETYRIMEVE FINANCIARE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA NËPUNËSVE PUBLIKË”, I NDRYSHUAR DHE SISTEMI ELEKTRONIK I DEKLARIMIT TË INTERESAVE PRIVATË

Inspektorati i Lartë, në zbatim të rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2021, ku është theksuar: *“Të angazhohet në përputhje me rekomandimet e progres raportit të KE dhe GRECO për përfundimin dhe vënien në funksionalitet të plotë brenda vitit 2021, të sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë, që do të kontribuojë drejtpërsëdrejti në forcimin e besueshmërisë së institucionit”*, ka vazhduar procesin e koordinimit dhe mbështetjes me burimet e nevojshme institucionale, me qëllim finalizimin e angazhimeve të marra në drejtim të ngritjes dhe vënies në funksionim të sistemit elektronik të deklarimit të interesave privatë.

Gjatë vitit 2021, ILDKPKI ka marrë masa për pilotimin e sistemit me disa institucione publike, me qëllim zgjidhjen e problemeve teknike që mund të ndodhnin, ndërkohë që sistemi do të ishte funksional. Gjatë kësaj periudhe, të gjitha çështjet teknike janë trajtuar nga kompania përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemit. Në zbatim të dispozitave ligjore të parashikuara në nenet 4/2, 21 dhe 42/2 të Ligjit nr. 9049/2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, ILDKPKI ka hartuar dhe miratuar aktet e nevojshme nënligjore dhe formularët e deklarimit.

Kështu, Inspektori i Përgjithshëm, me Urdhrin nr. 925 dhe Urdhrin nr. 926, datë 29.10.2021, ka miratuar përkatësisht formularët e deklarimit të interesave privatë në sistemin elektronik EACIDS. Ndërsa mënyra e plotësimit të deklaratave dhe afatet përkatëse të deklarimit janë miratuar me Udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm, nr. 927, datë 1.11.2021 *“Për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë në formë elektronike në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesit (EACIDS)”*. Në përmbushje të parashikimeve të këtij akti nënligjor, të gjithë subjektet deklarues do të fillojnë të deklarojnë përmes sistemit elektronik EACIDS, duke filluar nga data 1 janar 2022.

Udhëzimet dhe manualët, për plotësimin e këtyre formularëve, janë publikuar në faqen zyrtare të ILDKPKI, në seksionin e dedikuar për sistemin e deklarimit elektronik EACIDS, <https://www.ildkpk.al/akte-nenligjore/>.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, gjatë periudhës raportuese ka marrë masa për të zhvilluar një sërë sesionesh trajnuese për autoritetet përgjegjëse pranë institucioneve publike, ku gjatë muajit tetor 2021 janë trajnuar **130 përfaqësues**. Ndërsa gjatë muajit dhjetor 2021 janë trajnuar **152 pjesëmarrës të tjerë**.

Trajnimet e zhvilluara kishin për synim të rrisnin kapacitetet e përfaqësuesve të autoriteteve publike, që janë përgjegjëse për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave privatë, nga secili deklarues dhe personat e lidhur. Këto aktivitete shërbyen gjithashtu për t'i prezantuar pjesëmarrësve sistemin elektronik dhe modulet kryesore të tij, si dhe për të ofruar informacione teknike me synim lehtësimin e procesit të deklarimit online, përmes sistemit elektronik të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesave.

### 1.3 ZBATIMI I LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”, I NDRYSHUAR

Inspektorati i Lartë, në përmbushje të Rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në Rezolutën për vitin 2021, në të cilën është kërkuar: *“Të vijojë angazhimin në drejtim të rritjes së kapaciteteve të njësive përgjegjëse të ngritura në sektorin publik dhe privat në kuadër të zbatimit të ligjit për sinjalizimin, me qëllim ndërgjegjësimin për raportimin e praktikave të dyshuara të korrupsionit, përmes trajnimit të rregullt dhe informimit të anëtarëve të këtyre njësive. Në këtë drejtim t’i jepet prioritet bashkëpunimit me strukturat e Policisë së Shtetit, në adresimin e nevojave të tyre për trajnim e ndërgjegjësim në përputhje me rekomandimet e lëna nga GRECO”,* ka vijuar të ketë kontakte të ngushta me njësitë përgjegjëse, me qëllim përmbushjen e rekomandimit të lënë nga Kuvendi.

Në këtë drejtim, Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës prill - maj 2021, mori të gjitha masat e nevojshme për monitorimin dhe ngritjen e njësive përgjegjëse pranë institucioneve publike, në nivel qendror dhe vendor, të cilat kishin të punësuar mbi 80 punonjës. Gjatë këtij procesi, Inspektorati bashkëpunoi ngushtësisht me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Departamentin e Administratës Publike, si dhe me

Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të evidentuar autoritetet publike, të cilat plotësonin kufirin e kërkuar nga dispozitat ligjore.

Në vijim, ILDKPKI vendosi kontaktet përkatëse për ngritjen e njësive përgjegjëse dhe raportimin e tyre pranë Inspektoratit të Lartë. Me mbledhjen e informacionit të dërguar nga autoritetet publike, ILDKPKI përfundoi procesin e rishikimit të Regjistrisë Kombëtare të Njësive Përgjegjëse në Autoritetet Publike, në të cilin janë pasqyruar të dhënat dhe funksioni i personave të ngarkuar për të zbatuar ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në total janë ngritur dhe funksionojnë 362 njësi përgjegjëse në sektorin publik.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë koordinoi punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për identifikimin e organizatave private, të cilat kishin të punësuar mbi 100 punonjës, për të vendosur kontaktet përkatëse për ngritjen e njësive përgjegjëse dhe raportimin e tyre pranë Inspektoratit. Në vijim të informacionit të marrë, u rishikuan dhe u përditësuan të dhënat e Regjistrisë Kombëtare të Njësive Përgjegjëse në Sektorin Privat, në të cilin janë pasqyruar të dhënat dhe funksioni i personave të ngarkuar, për të zbatuar ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në total janë ngritur dhe funksionojnë 527 njësi përgjegjëse në sektorin privat.

Në përfundim të procesit, përgjatë periudhës prill - maj 2021, për organizatat të cilat kishin detyrimin për krijimin dhe raportimin e njësive përgjegjëse, por që nuk e përmbushën këtë detyrim brenda afateve ligjore të parashikuara nga Ligji nr. 60/2016, i ndryshuar, u aplikuan masat administrative “gjobë”, për rreth **48 organizata**. Kështu për periudhën 2016 - 2021 janë aplikuar gjithsej **188 masa administrative** me “gjobë” ndaj organizatave, që nuk kanë respektuar detyrimin për krijimin e Njësive Përgjegjëse.

Gjithashtu, në zbatim të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE në Shqipëri, gjatë periudhës 24 qershor – 2 korrik 2021, zhvilloi disa sesione trajnimi me njësitë përgjegjëse të sektorit privat, për rritjen e kapaciteteve mbi dispozitat e ligjit, mekanizmat e vendosur për raportimin e akteve dhe praktikave të dyshuara të korrupsionit, si dhe mbrojtjen që ligji ofron për sinjalizuesit. Programi i trajnimit u realizua gjatë 7 sesioneve trajnuese, për ngritjen e kapaciteteve të njësive

përgjegjëse në sektorin privat, kryesisht duke pasur në fokus njësitë e krijuara rishtazi. Në përfundim të këtyre sesioneve u trajnuan **220 anëtarë** të njësive përgjegjëse, në sektorin privat.

Në kuadër të seancave të trajnimit, me mbështetjen e Prezencës së OSBE në Shqipëri, do të hartohet një Udhëzues me pyetjet dhe përgjigjet më të shpeshta, që kanë rezultuar në sesionet trajnuese të organizuara ndër vite, për njësitë përgjegjëse në sektorin privat. Udhëzuesi, i cili do t'ju shërbejë njësive përgjegjëse të sektorit privat, që kanë detyrim për zbatimin e ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, përmban pyetje dhe përgjigje të ndryshme në lidhje me: ligjin dhe konceptet e tij, rolin e sinjalizuesve dhe të njësive përgjegjëse, mekanizmat e mbrojtjes së sinjalizimit, procedurat dhe politikat e brendshme që duhet të miratojnë kompanitë, mënyrën e raportimit pranë ILDKPKI dhe afatin kohor të raportimit, si mund të mbrohen në mënyrë efektive sinjalizuesit dhe cilat janë garancitë ligjore.

Për më tepër, në përmbushje të kompetencave ligjore, Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës raportuese, ka ushtruar kontroll në **192 njësi përgjegjëse** në sektorin publik, me fokus verifikimin e ngritjes, funksionimit të njësive përgjegjëse, zbatimin e kërkesave të VKM nr. 818, datë 16.11.2016 *“Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike”*, hartimin dhe miratimin e rregulloreve të kërkuara nga kuadri ligjor në fuqi, përgatitjen dhe plotësimin e regjistrit për regjistrimin e rasteve të sinjalizimit dhe të rasteve të mbrojtjes nga hakmarrja, përgatitja dhe dërgimin e raportit vjetor me shkrim për sinjalizimet e regjistruara, mënyrat e ndjekura për hetimin administrativ të sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

Në përfundim të procesit të kontrollit u hartua raporti përkatës, në të cilin është evidentuar shkalla e njohjes së kuadrit ligjor për sinjalizimin dhe zbatimin e tij nga njësitë përgjegjëse në këtë sektor, si dhe janë hartuar rekomandime për njësitë që duhet të sjellin veprimtarinë e tyre në përputhje me këtë kuadër. Për më tepër, në zbatim të pikës 6 të VKM nr. 816, datë 16.11.2016, u rekomandua dhe u bë i mundur kalimi i 179 autoriteteve publike të varësisë/degë territoriale, në njësinë përgjegjëse qendrore të institucionit përkatës publik.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, ILDKPKI, përgjatë vitit raportues, mbajti kontakte të vazhdueshme me Njësitë Përgjegjëse në sektorin publik dhe privat, duke administruar dhe analizuar raportimet e dërguara prej tyre, si dhe duke bërë përditësimet e nevojshme në Regjistrin Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në Autoritetet Publike dhe në Regjistrin Kombëtar të Njësive Përgjegjëse në sektorin privat. Nga të dhënat statistikore, rezulton se në total janë

ngritur dhe funksionojnë **362 njësi përgjegjëse** në sektorin publik, si dhe **527 njësi përgjegjëse** në sektorin privat.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të parashikimeve të neneve 13 dhe 22, të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, brenda datës 15 janar 2022 ka pritur dhe administruar raportet vjetore të dërguara nga Njësitë Përgjegjëse, si nga autoritetet publike dhe organizatat private.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë ka marrë dhe administruar 199 raporte vjetore nga Njësitë Përgjegjëse pranë autoriteteve publike, ku nga analizimi i tyre konstatohet se në 3 Njësi Përgjegjëse janë sinjalizuar dhe trajtuar raste, në kuadër të Ligjit nr. 60/2016, i ndryshuar, si më poshtë:

- 1. Banka e Shqipërisë.** Gjatë vitit 2021 është adresuar elektronikisht prezantimi mbi këtë funksion për të gjithë nëpunësit e Bankës së Shqipërisë për të rikujtuar, ndërgjegjësuar dhe stimuluar raportimet e rasteve të mundshme të korrupsionit. Në rrjedhim të kësaj, për vitin 2021 është raportuar pranë adresës së dedikuar, rast apo veprim i dyshuar, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedurës së hetimit administrativ, si rrjedhojë e tërheqjes së sinjalizimit.
- 2. Bashkia Tiranë.** Raportohen të jenë regjistruar 6 raste sinjalizimi, për të cilat janë kryer veprimet procedurale, në zbatim të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar.
- 3. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.** Raportohen 2 raste sinjalizimi, për të cilat janë marrë masat për nxjerrjen përpara përgjegjësive të personave të gjetur në shkelje të përmbushjes së detyrave funksionale, deri në referim të çështjes pranë organit të prokurorisë.




Në lidhje me Njësitë Përgjegjëse pranë sektorit privat janë marrë dhe janë administruar 321 raporte sinjalizimi në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 60/2016, i ndryshuar, në të cilat nuk janë raportuar raste të sinjalizimit.

Gjithashtu, gjatë vitit raportues, në ushtrim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja, Inspektorati i Lartë ka regjistruar dhe trajtuar në total **11 raste sinjalizimi** dhe **1 kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja**, të ardhur nga sektori publik. Në analizim të rasteve të paraqitura, rezulton se 10 raste sinjalizimi të jashtëm kanë ardhur nga sektori publik dhe 1 rast i përket sektorit privat.

ILDKPKI ka marrë masa për të regjistruar të gjitha rastet e sinjalizuara, në Regjistrin e Sinjalizimeve të Jashtme, në Regjistrin e Kërkesës për Mbrojtje nga Hakmarrja, si dhe ka hetuar administrativisht sinjalizimet e jashtme dhe kërkesën për mbrojtje, në përputhje me procedurën e përcaktuar në dispozitat e Ligjit nr. 60/2016, i ndryshuar dhe Kodit të Procedurave Administrative, duke respektuar afatet ligjore.

Në përfundim të hetimeve administrative, për procedurat të cilat kanë rezultuar të kryera në shkelje të kuadrit ligjor të zbatueshëm, për rastin në shqyrtim është kërkuar ndaj titullarit të institucionit marrja e masave për zgjidhjen e situatave të paligjshmërisë, deri në largimin e nëpunësve, si dhe zgjidhjen e rastit me konflikt interesi.

Për rastet e sinjalizuara, pas kryerjes së hetimeve administrative, janë vënë në dijeni edhe organet kompetente, sipas problematikave të ngritura nga sinjalizuesit, si vijon:

-  Njoftim pranë KLSH për auditim të fondeve publike;
-  Njoftim për ndjekje të mëtejshme, strukturave të policisë së shtetit;
-  Njoftim për ndjekje të mëtejshme nga Autoriteti Publik Qendror.

Lidhur me kërkesën për mbrojtje nga hakmarrja, pas regjistrimit në Regjistrin e Kërkesës për Mbrojtje nga Hakmarrja, u zhvillua hetimi administrativ, në përputhje me procedurën e përcaktuar në dispozitat e Ligjit nr.60/2016, i ndryshuar dhe Kodit të Procedurave Administrative dhe u njoftua autoriteti publik, për marrjen e masave paraprake, për mbrojtjen nga hakmarrja të sinjalizuesit.

## 2 TË DHËNA MBI DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E DEKLARATAVE TË INTERESAVE PRIVATË

### 2.1 ADMINISTRIMI I DEKLARATAVE, SKANIMI, PËRPUNIMI PARAPRAK DHE KONTROLLI ARITMETIK DHE LOGJIK

Gjatë vitit 2021, Inspektorati i Lartë ka vijuar punën për procesin e pranimit, regjistrimit dhe administrimit të deklaratave të interesave privatë, të subjekteve që mbartin detyrim për deklaram.

Nga të dhënat e regjistruara dhe të administruara nga Sektori i Protokoll Arkivës dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë, rezulton se numri i përgjithshëm i subjekteve (subjekte në funksion, ish-subjekte deklarues) deri më **31.12.2021** është **16,636 subjekte deklaruese**, nga të cilët:

- **16.6 % ose 2,774 subjekte rezultojnë të jenë në funksion;**
- **79.7 % ose 13,250 rezultojnë të jenë ish-subjekte deklarues;**
- **3.7 % ose 612 rezultojnë të jenë kandidatë.**

Numri i deklaratave të administruara nga Inspektorati i Lartë për vitin 2021, është **4032 deklaratat të interesave privatë**, nga të cilat, të ndara sipas llojeve të tyre, rezultojnë këto të dhëna statistikore:

- Deklarata Periodike/Vjetore (për vitin deklarues 2020) – **2,756 deklaratat;**
- Deklarata Para Fillimit të Detyrës (2021) – **499 deklaratat;**
- Deklarata Pas Largimit nga Funkzioni (2021) – **503 deklaratat;**
- Deklarata Kandidatë (2021) – **274 deklaratat.**

Sikurse mund të vihet re, 68.4% e totalit të deklaratave të interesave privatë, të administruara nga ILDKPKI gjatë vitit 2021, përbëhet nga deklaratat Periodike/Vjetore, 12.4% nga deklaratat Para Fillimit të Detyrës, 12.5% e tyre përbëhet nga deklaratat Pas Largimit nga Funkzioni, si dhe 6.7 % e përbëjnë deklaratat e kandidatëve.

Inspektorati i Lartë, gjatë vitit raportues, ka administruar **4,032 deklaratat të interesave privatë**. Të gjitha deklaratat, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 24 i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...*”, i ndryshuar, që



parashikon kalimin në fazën e skanimit, kontrollit të përpunimit paraprak, kryesisht lidhur me juridiksionin, rregullsinë e plotësimit të deklaratës, i janë nënshtruar këtij procesi, të përfunduar brenda vitit 2021. Për më tepër, njëkohësisht me procesin e skanimit dhe kontrollit paraprak, në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 25 i Ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, është kryer dhe procesi i kontrollit aritmetik dhe logjik, mbi saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara.

## 2.2 KONTROLLI I PLOTË DHE REZULTATET E KONTROLLIT

Inspektorati i Lartë, gjatë vitit 2021, në zbatim të nenit 25/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...”*, i ndryshuar, si dhe në përmbushje të objektivit kryesor të veprimtarisë së tij, lidhur me ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimin administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, ka miratuar dhe ka kaluar në kontroll të plotë në **total 802 subjekte deklarues**, si për shkak funksioni, ashtu edhe bazuar në informacione të ardhura nga denoncimet në numrin pa pagesë **0800 9999**, postën zyrtare dhe elektronike, median e shkruar, audio-vizive, etj.

Inspektorati i Lartë, në përmbushje të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për vitin 2021 ka përmbushur kompetencat ndëshkuese, përmes aplikimit të masave administrative, “gjobë”, propozimeve për masa deri në largim nga detyra, drejtuar institucioneve publike, si dhe referimeve penale dhe të tjera, të depozituara pranë organit të akuzës, strukturave të hetimit tatimor, Policisë së Shtetit, ndaj zyrtarëve-subjekte deklarues, të cilët janë gjetur në shkelje të ligjit.

Në këtë kuadër, Inspektorati i Lartë, në zbatim të nenit 44, të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave...”*, i ndryshuar dhe neni 40, të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...”*, i ndryshuar, ka aplikuar masën administrative “gjobë”, për rastet e refuzimeve për deklarim, si dhe për rastet e mosdeklarimeve dhe/apo për çështje të konfliktit të interesave. Të ndëshkuar me masa administrative “gjobë”,



për periudhën deri më 31.12.2021, janë në **total 130 zyrtarë**. Për periudhën 2014 – 2021 janë sanksionuar me masë administrative “gjobë”, në total, rreth **1.889 zyrtarë**.

Për t’u theksuar është fakti se të gjitha masat administrative të vendosura nga Inspektorati i Lartë janë lënë në fuqi nga Gjykata Administrative, me përjashtim të një numri të pakonsiderueshëm, për të cilat gjykata ka vendosur shfuqizimin ose ndryshimin e tyre.

Për më tepër, Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës 2014 – 2021, ka referuar pranë Institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, si dhe Policisë së Shtetit, **518 subjekte**, në të cilët janë përfshirë zyrtarë të nivelit të lartë drejtues, si Deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Kryetarë Bashkie, Drejtorë Drejtorie etj. Për periudhën raportuese janë paraqitur në **total 16 raste referimesh penale dhe referime të tjera**.

Në përmbushje të Rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në Rezolutën për vitin 2021, në të cilin kërkohet: *“Të intensifikojë trajnimet e stafit në drejtëm të rritjes së kapaciteteve administrative dhe investiguese, për të qenë kështu garant i paanshmërisë, transparencës dhe objektivitetit të institucionit”*, Inspektorati i Lartë, në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë ka zhvilluar, si dhe ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve trajnuese. Vlen të përmendet pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me PAMECA V, mbi veprat penale në fushën e Pastrimit të Parave dhe Hetimit Financiar, si dhe veprat penale të lidhura me detyrën.

Gjithashtu, u organizuan, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, në kuadër të Programit Mbështetja Horizontale II, sesione trajnuese për inspektorë dhe ndihmës inspektorë për verifikimin dhe hetimin e deklaratave të interesave privatë, me një këndvështrim krahasues me praktikën më të mirë evropiane dhe ndërkombëtare. Për më tepër, në bashkëpunim me GIZ, u organizua dhe u zhvillua sesion trajnues mbi praktikën më të mirë për hetimin dhe identifikimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të lidhura me të. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, ILDKPKI mori pjesë në aktivitetin trajnues të organizuar nga RAI, mbi njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave rajonale në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

### 3 ROLI PARANDALUES/NDËRGJEGJËSUES DHE BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL E NDËRKOMBËTAR

#### 3.1 ROLI PARANDALUES DHE NDËRGJEGJËSUES

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka qenë gjithnjë i angazhuar në rolin ndërgjegjësues dhe parandalues, në funksion të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave...”, i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 60/20162016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar.

Për më tepër, përgjatë vitit raportues, në përmbushje të Rekomandimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në Rezolutën për vitin 2021, që kërkon: ***“Bashkëpunimin e mëtejshëm dhe dhënien e asistencës së nevojshme, përfshirë udhëzime specifike, këshilla dhe trajnime për zbatimin e duhur të kuadrit ligjor për parandalimin e konfliktit të interesave, veçanërisht për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse në evidentimin e deklarimeve rast pas rasti, të cilat nga raportet e organizmave ndërkombëtare nuk zbatohen”***, në mënyrë periodike, por edhe rast pas rasti në bazë kërkesash, ka ofruar asistencë teknike dhe ligjore për autoritetet përgjegjëse, si strukturat kryesore për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave brenda institucionit, ku ushtrojnë funksionet e tyre.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, u organizuan sesione trajnuese për deputetët që morën mandatin në legjislaturën e fundit mbi njohjen e kuadrit ligjor për parandalimin e konfliktit të interesave dhe detyrimet e tyre në zbatim të këtij kuadri.

Në vijim të bashkëpunimit me Agjencinë e Prokurimit Publik, për zbatimin e kuadrit të ri në fushën e prokurimeve publike, në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesave, u nënshkrua një Memorandum Bashkëpunimi, qëllimi kryesor i të cilit ishte bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, në funksion të rritjes së integritetit të zyrtarëve në prokurimet publike dhe ndërgjegjësimin e tyre për zhvillimin e procedurave, në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar nga interesat privatë.

Duke qenë se autoritetet përgjegjëse janë ato që evidentojnë, administrojnë dhe trajtojnë konfliktin e interesave rast për rast, çdo herë, kur institucionet publike i janë drejtuar zyrtarisht Inspektoratit të Lartë, duke i kërkuar asistencë ligjore për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesave, Inspektorati i Lartë është përgjigjur duke organizuar takime të veçanta sqaruese me zyrtarë të niveleve të ndryshme brenda të njëjtit institucion mbi problematikat e ndeshura, institucionale apo individuale. Përgjatë vitit raportues janë marrë dhe trajtuar më shumë se 33 kërkesa të ardhura nga autoritetet përgjegjëse apo zyrtarë, të cilët janë asistuar mbi çështje të lidhura me parandalimin e konfliktit të interesave.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë në përmbushje të detyrimit ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka administruar brenda afatit ligjor, raportet e dërguara nga çdo autoritet përgjegjës lidhur me veprimtarinë e kryer prej tyre në zbatim të ligjit, përfshirë edhe rastet e konfliktit të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarin periodik të interesave privatë.

### 3.2 BASHKËPUNIMI NDËR-INSTITUCIONAL E NDËRKOMBËTAR

Inspektorati i Lartë, ka vijuar forcimin e urave të bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese, duke pasur në fokus dhe përmbushjen e Rekomandimit të Kuvendit në Rezolutën për vitin 2021: *“Të forcohet bashkëpunimi mes ILDKPKI dhe SPAK për të përmirësuar në mënyrë të efektshme ndjekjen e çështjeve të adresuara në prokurori nga ILDKPKI-ja në kuadër të refuzimit për deklarin, mosdeklarin, fshehjen ose deklarin e rremë të pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose të çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarin, veçanërisht për persona të cilëve u janë ngarkuar funksione të larta ekzekutive”.*

Në këtë kuadër, në forcimin e bashkëpunimit me SPAK, ILDKPKI ka marrë të gjitha masat institucionale për të kryer në kohë sa më të shkurtër verifikimin e deklaratave të interesave private, për kandidatë që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e BKH, si dhe personel administrativ pranë SPAK. Për më tepër, në vijim të mbështetjes së strukturave të SPAK, mbi hetimet e nisura për zyrtarë, të cilët janë subjekte të deklarin të interesave privatë, ka

vendosur në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm, të administruar pranë Inspektoratit të Lartë për këto subjekte. Në kuadër të plotësimit të rekomandimit është hartuar dhe është drejt përfundimit nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndër-institucional, midis Inspektoratit të Lartë dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Inspektorati i Lartë, përtej përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi, ka vazhduar të japë në mënyrë periodike/mujore arritjet dhe sfidat institucionale të tij, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të Bashkimit Evropian (BE), duke i'u përgjigjur në kohë institucioneve të tjera shtetërore, të përfshira në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian.

ILDKPKI, përgjatë vitit raportues, ka vijuar bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Këshillin e Evropës, zyrën e OSBE në Tiranë, si dhe është angazhuar me pjesëmarrjen në takime, tryeza të rrumbullakëta, konferenca dhe seminare, të organizuara elektronikisht, për çështje që lidhen me luftën kundër korrupsionit. Konkretisht, përfaqësues të ILDKPKI morën pjesë në trajnimet e organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me projektin PAMECA V, mbi pastrimin e parave dhe hetimin pasuror e financiar dhe veprat penale që lidhen me detyrën, si dhe në seminarin “Whistleblower Directive for the Western Balkans” organizuar nga DG- Just, me mbështetjen e TAIEX.

Gjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë vijoi përmbushjen e angazhimeve të marra, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me RAI, për projektin e financuar nga BE “*Breaking the Silence: Enhancing the Whistleblowing Policies and Culture in Western Balkans and Moldova*” (Thyerja e heshtjes: Përmirësimi i politikave dhe kulturës së sinjalizimit në Ballkanin Perëndimor dhe Moldavi). Kështu, ILDKPKI mori pjesë në aktivitetin trajnues të organizuar nga RAI, mbi njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave rajonale në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve, si dhe në hartimin e raportit, mbi vlerësimin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor në fuqi me direktivën e BE, për mbrojtjen e personave që raportojnë.

#### 4 REKOMANDIMET E GRUPIT TË SHTETEVE KUNDËR KORRUPSIONIT (GRECO)

Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës raportuese ka vijuar aktivitetin institucional duke pasur në fokus rekomandimet e drejtuara Republikës së Shqipërisë nga GRECO, në Raundin e Pestë të Vlerësimit për Shqipërinë, që trajton: *“Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në pushtetin qendror (funksione të larta ekzekutivi) dhe në agjenci ligjzbatuese”*. Përbushja e Rekomandimeve të GRECO V është pjesë dhe e rekomandimeve të lëna nga Komisioni Evropian në Raportin për Shqipërinë të publikuar në tetor 2021, ku në pjesën e luftës kundër korrupsionit për institucionet rekomandohet: *“Të adresojë në mënyrë efektive rekomandimet e GRECO-s dhe të zbatojë planin e veprimit ....”*.

Në Raportin e Vlerësimit të Raundit të Pestë për Shqipërinë, të miratuar nga GRECO, për rekomandimet që kishin të bënin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e ILDKPKI, GRECO rekomandoi:

- ✚ Rekomadimi X: *“Të bëhet funksionale sa më shpejt të jetë e mundur, platforma elektronike e krijuar për deklarin dhe publikimin e deklarimeve të pasurisë dhe interesit”*.

Në lidhje me këtë rekomandim, gjatë vitit 2021, ILDKPKI mori të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar përbushjen e tij në mënyrë të plotë. Konkretisht, në planin e masave të hartuara, u mundësua pilotimi i sistemit në disa institucione, me qëllim zgjidhjen e problemeve teknike që mund të ndodhnin, ndërkohë që sistemi do të ishte funksional. Gjatë kësaj periudhe, të gjitha çështjet teknike të dala gjatë pilotimit, u trajtuan në bashkëpunim me kompaninë përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemit.

Për më tepër, në zbatim të dispozitave ligjore, të parashikuara në nenet 4/2, 21 dhe 42/2 të Ligjit nr. 9049/2003 *“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, Inspektorati i Lartë hartoi dhe miratoi aktet e nevojshme nënligjore dhe formularët e deklarin për sistemin elektronik.

Kështu, Inspektori i Përgjithshëm, me Urdhrin nr. 925 dhe Urdhrin nr. 926, datë 29.10.2021, miratoi përkatësisht formularët e deklarimit të interesave privatë në sistemin elektronik EACIDS. Njëkohësisht, u hartua dhe u miratua, Udhëzimi i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 927, datë 1.11.2021 *“Për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë në formë elektronike në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesave”*, në të cilin janë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e subjekteve të përfshirë në procesin e deklarimit elektronik. Në zbatim të këtij akti nënligjor, të gjitha subjektet deklaruese do të fillojnë të deklarojnë përmes sistemit elektronik EACIDS, duke filluar **nga data 1 janar 2022**. Udhëzimet dhe manualët për plotësimin e këtyre formateve janë publikuar në faqen zyrtare të ILDKPKI, në seksionin e dedikuar për sistemin e deklarimit elektronik EACIDS.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, gjatë muajve tetor - dhjetor 2021, zhvilloi aktivitete trajnuese për autoritetet përgjegjëse pranë institucioneve publike, ku u trajnuan 282 përfaqësues të autoriteteve përgjegjëse. Trajnimet e zhvilluara kishin për synim të rrisnin kapacitetet e përfaqësuesve të autoriteteve publike, që janë përgjegjëse për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave privatë nga secili deklarues dhe personat e lidhur. Këto aktivitete shërbyen gjithashtu për t'i prezantuar pjesëmarrësve sistemin elektronik dhe modulet kryesore të tij, si dhe për të ofruar informacione teknike me synim lehtësimin e procesit të deklarimit, përmes sistemit elektronik të deklaratave të pasurisë dhe konfliktit të interesit.

✚ Rekomandimi XI: *“Të sigurohen burimet e nevojshme ligjore, njerëzore, financiare dhe burime të tjera, në mënyrë që ILDKPKI të përmirësojë kapacitetin e tij për të kryer verifikimin efikas të deklaratave të pasurive dhe interesave privatë”*.

Në lidhje me këtë rekomandim, përgjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë ka qenë i angazhuar për të organizuar, si dhe për të marrë pjesë në një sërë aktivitete trajnuese, në bashkëpunim me partnerët kryesorë ndërkombëtarë.

Kështu, institucioni u angazhua për të marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me PAMECA V, mbi veprat penale në fushën e pastrimit të Parave dhe Hetimin Financiar, si dhe veprat penale të lidhura me detyrën.

Gjithashtu, u organizuan, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, në kuadër të Programit Mbështetja Horizontale II, sesione trajnuese për verifikimin dhe hetimin e deklaratave të interesave privatë, me një këndvështrim krahasues me praktikatat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Për më tepër, në bashkëpunim me GIZ, u organizua dhe u zhvillua sesion trajnues mbi praktikatat më të mira për hetimin dhe identifikimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të lidhura me të. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, ILDKPKI mori pjesë në aktivitetin trajnues të organizuar nga RAI, mbi njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave rajonale, në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Në mbështetjen e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare, vlen të theksohet adresimi i kërkesave të institucionit, për përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për rritjen e efektivitetit të proceseve të punës. Konkretisht, mbështetja buxhetore, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kërkesat e institucionit, ka ardhur në rritje, ku për vitin 2019 Inspektoratit të Lartë i është alokuar vlera buxhetore prej 142,700,000 lekë, në vitin 2020 vlera prej 158,500,000 lekë dhe në vitin 2021 vlera prej 195,944,000 lekë.

Në lidhje me Rekomandimet XII dhe XXIV, sjellim në vëmendje se nuk janë rekomandime të cilat i adresohen më mënyrë të drejtpërdrejtë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, por janë rekomandime që kërkojnë marrjen e masave nga institucionet përkatëse në bashkëpunim me ILDKPKI.

Kështu, për Rekomandimin XII, *“i) të përfundojë si një çështje me përparësi rekrutimi i stafit të prokurorisë dhe stafit teknik në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) dhe që anëtarëve të tij t’u ofrohen burime të përshtatshme njerëzore dhe teknike dhe prokurorët të marrin trajnim specializimi të lartë, dhe ii) të vendoset në mënyrë efektive bashkëpunimi i duhur me ILDKPKI, për të përmirësuar në mënyrë të efektshme zbatimin e raporteve të ILDKPKI në rastin e shkeljes së ligjeve mbi konfliktin e interesave dhe deklaratimit të pasurisë nga PTEF dhe punonjësit e policisë”*, ILDKPKI ka marrë të gjitha masat institucionale, për të



kryer në kohë sa më të shkurtër verifikimin e deklaratave të interesave privatë për kandidatët që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e BKH, si dhe personel administrativ pranë SPAK. Për më tepër, në vijim të mbështetjes së strukturave të SPAK, mbi hetimet e nisura për zyrtarë të cilët janë subjekte të deklarimit të interesave privatë, ka vendosur në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm të administruar pranë Inspektoratit të Lartë për këto subjekte. Në kuadër të plotësimit të rekomandimit është hartuar dhe është drejt përfundimit nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndër-institucional.

Në lidhje me Rekomandimin XXIV, *“Të sigurohet efektiviteti i zbatimit të ligjit për sinjalizuesit, sidomos përmes trajnimit të rregullt dhe informimit të stafit të policisë për masat e mbrojtjes së sinjalizimit”*, ILDKPKI ka shprehur angazhimin për të asistuar Policinë e Shtetit në aktivitetet trajnuese, që do të planifikohen dhe organizohen brenda kurrikulave të trajnimeve që ofron ky institucion për nëpunësit e policisë.

## 5 PERFORMANCA FINANCIARE

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2021, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, si dhe Ligji nr. 60/2016, datë 2.6.2016, *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, i ndryshuar, duke paraqitur një realizim të shpenzimeve buxhetore për vitin 2021, si më poshtë vijon:

Në mbështetje të Ligjit nr. 137/2020 *“Për buxhetin e vitit 2021”*, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.9, datë 30.3.2018 *“Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”*, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është akorduar fondi buxhetor prej **157 milion e 99 mijë e 520 lekë**, i cili përbëhet nga:



Fondi i Pagave: 102 milion e 860 mijë lekë (zëri 600)

Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 15 milion e 400 mijë lekë (zëri 601)

Fondi për Shpenzime Operative: 35 milion e 100 mijë lekë (zëri 602)

Fondi për Investime: 3 milion lekë (zëri 231)

Transferime korrente: 739 mijë e 520 lekë (zëri 606)

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, i ndryshuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në shumën 149,423,069.93 lekë ose 95.11 %, të fondit të planifikuar për vitin 2021.

ILDKPKI, referuar buxhetit të vitit 2021, ka zbatuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara, si dhe shpenzimet e tjera, më të domosdoshme, në mbështetje të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u realizua në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë këtij viti, numri i punonjësve u realizua deri në 70 punonjës, nga 70 punonjës të miratuar me Vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. 48, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, i ndryshuar.

Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve, në vlerën 98,085,488 lekë ose 95,36% e fondit të planifikuar për periudhën respektive dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 14,638,907 lekë ose 95,06%, e fondit të planifikuar për periudhën respektive.

Për vitin 2021, janë kryer procedura rekrutimi në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe

dispozitave ligjore në mbështetje të tij, për pozicionet vakante në kategorinë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese, si dhe nivelin e lartë drejtues.

Për më tepër, në lidhje me fondin e planifikuar të investimeve për vitin 2021, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë u alokua si fond vlera prej 3,000,000 lekë, nga e cila Inspektorati i Lartë, në mbështetje të procedurave të prokurimit publik, realizoi vlerën prej 2,667,000 lekë ose 88.90% të fondit.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi, gjatë vitit 2021, në realizimin e shpenzimeve operative, është mbështetur në kërkesa të cilat lidhen me:

- ✓ Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrimet për taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare, në funksion të një veprimtarie normale institucionale, të cilat për periudhën e raportuar janë realizuar në masën 100% të fondit të planifikuar vjetor;
- ✓ Realizimin e shpenzimeve për blerje materialesh e shërbimesh, sipas nevojave konkrete, për krijimin dhe përmirësimin e kushteve të punës në realizimin e një aktiviteti normal institucional;
- ✓ Forcimin e mekanizmave investigues për pasuritë e paluajtshme në terren dhe interesave privatë të zyrtarëve, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës teknologji – informacion.

Zëri i shpenzimeve operative për vitin 2021 u realizua në vlerën 33,442,154.59 lekë ose 95,28% e fondit të planifikuar për këtë periudhë, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Gjatë këtij viti, shpenzimet buxhetore të domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara krahas prokurimit me tender, janë realizuar dhe me blerje të vogël, sipas procedurës elektronike dhe janë lidhur kontrata në mbështetje të specifikimeve teknike, të sanksionuara në marrëveshjet dypalëshe. Shpenzimet e domosdoshme, të planifikuara dhe të miratuara gjejnë realizim, sipas nevojave konkrete të institucionit.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI për vitin 2021, kanë ardhur kryesisht nga arkëtimi i sanksioneve administrative me gjobë, të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, gjatë zbatimit të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, Ligjit nr.

9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; Ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, si dhe ekzekutimit të detyrueshëm nga Zyrat e Përmbarimit, për një vlerë totale prej **20.006.849 lekë**. Këto të ardhura, në zbatim të VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Mbi të ardhurat në institucionet buxhetore”, kanë kaluar në Buxhetin e Shtetit, në masën 100%.

## 6 TRANSPARENCA INSTITUCIONALE

Inspektorati i Lartë në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, ka trajtuar të gjitha kërkesat e ardhura nga shoqëria civile, individë apo media, brenda afatit 10 ditor, pavarësisht fluksit të kërkesave dhe procesit të përpunimit manual për redaktimin e të dhënave personale.

Konkretisht, ILDKPKI për periudhën 2014 - 2021 ka publikuar rreth 61,933 deklarata të interesave privatë, ku vetëm për vitin 2021 rezultojnë të publikuara 3,553 deklarata. Për t’u theksuar mbetet fakti se nuk janë paraqitur kontestime apo ankesa nga palët e interesuara, çka tregon për një punë korrekte dhe serioze të institucionit.

## 7 PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE

Inspektorati i Lartë në kuadër të rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2021, si dhe me qëllim përmbushjen e angazhimeve të marra në drejtim të rritjes së performancës institucionale, gjatë vitit raportues ka patur këto arritje kryesore:

- Mbështetjen e proceseve të verifikimit të kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të deritanishëm me institucionet e rivlerësimit dhe ONM. Në këtë kuadër, ka trajtuar me përparësi **më shumë se 155 kërkesa** të ardhura nga organet e rivlerësimit, duke vendosur në dispozicion dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të përcaktuara, si dhe ka kryer verifikimin e **312 kandidatëve** në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë, si për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, gjyqtarë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatat e Apelit, hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit,

magjistratë dhe dërgimin e akteve të kontrollit, së bashku me dosjet përkatëse pranë KED, KLGJ, KLP dhe organeve të tjera të emërtesës.

- Zbatimin me rigorozitet të skemës së kontrollit të plotë, ushtrimin e kontrollit të plotë dhe hetimit administrativ për vërtetimin e saktësisë dhe vërtetësisë së të dhënave të pasurive, të ardhurave e detyrimeve të deklaruara nga zyrtarët dhe personat e lidhur me ta, konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, **për 802 subjekte deklaruese**.
- Ndëshkrimin e subjekteve deklarues të gjetur në shkelje të kuadrit ligjor, duke aplikuar **130 masa administrative “gjobë”** dhe depozituar **16 referime penale dhe referime të tjera** pranë institucionit të Prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor, si dhe strukturave të Policisë së Shtetit.
- Plotësimin e kuadrit nënligjor për të garantuar vënien në funksionim të sistemit të deklarimit të interesave privatë, si dhe organizimin e sesioneve trajnuese për më shumë se **282 autoritete përgjegjëse**, mbi procedurat dhe mënyrën e plotësimit të deklarimit të interesave privatë në mënyrë elektronike.
- Vijimin e aktivitetit institucional dhe marrjen e masave për të përmbushur rekomandimet e drejtuara Republikës së Shqipërisë nga GRECO, në Raundin e Pestë të Vlerësimit për Shqipërinë, që trajton: *“Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në pushtetin qendror (funksione të larta ekzekutivi) dhe në agjenci ligjzbatuese”*, të ritheksuara nga Komisioni Evropian në Raportin për Shqipërinë, të publikuar në tetor 2021.
- Angazhimin në drejtim të zbatimit të Ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 *“Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”*, i ndryshuar, duke marrë masa në drejtim të monitorimit të ngritjes së njësive përgjegjëse pranë organizatave publike dhe private, si dhe aplikimin e rreth 48 masave administrative me “gjobë” për organizatat e gjetura në shkelje të detyrimeve ligjore. Për më tepër, në drejtim të rritjes së kapaciteteve të njësive përgjegjëse të ngritura në sektorin publik dhe privat në kuadër të zbatimit të ligjit për sinjalizimin, u organizuan inspektime pranë **192 institucioneve publike**, si dhe sesione trajnuese për më shumë se **220 njësi përgjegjëse** në sektorin privat.
- Vijimin e rolit parandalues dhe monitorues të zbatimit të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, duke ofruar asistencë teknike dhe ligjore për autoritetet përgjegjëse, si strukturat kryesore për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave brenda institucionit, si dhe organizimin në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

të sesioneve trajnuese për deputetët, që morën mandatin në legjislaturën e fundit mbi njohjen e kuadrit ligjor, për parandalimin e konfliktit të interesave dhe detyrimet e tyre në zbatim të këtij kuadri.

- Ndjekjen e një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile, ku të gjitha kërkesat e paraqitura për publikim të deklaratave të interesave privatë, janë trajtuar në përputhje me afatet ligjore, gjë që ka rezultuar në **publikimin e rreth 3,553 deklaratave të interesave privatë**, gjatë vitit 2021.

## 8 PRIORITETET PËR VITIN 2022

- Vijimi i mbështetjes së proceseve për verifikimin e kandidatëve në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë dhe forcimi i bashkëpunimit me organet përkatëse të emërtesës, me qëllim përfundimin e ngritjes dhe funksionimit të institucioneve të dala nga reforma në drejtësi.
- Ndjekja dhe zbatimi i skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë të subjekteve deklarues, në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara nga Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin...”, i ndryshuar, si dhe Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave...”, i ndryshuar.
- Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit nr. 60/2016, datë 2.6.2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, në drejtim të forcimit të marrëdhënieve me njësitë përgjegjëse, në ndjekje të rekomandimeve të lëna, si rrjedhojë e procesit të monitorimit. Regjistrimi dhe hetimi i rasteve të sinjalizimeve të jashtme brenda afateve ligjore dhe marrja e masave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- Hartimi dhe marrja e masave institucionale, në drejtim të mirëfunksionimit të sistemit të ri të deklarimit të interesave privatë në mënyrë elektronike, me fokus rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse, si dhe asistimi i subjekteve në procesin e familjarizimit me procedurën dhe mënyrën e përdorimit të këtij mekanizmi të ri.
- Ndjekja me përparësi e rekomandimeve të lëna nga organizatat ndërkombëtare, në drejtim të përmbushjes së angazhimeve të marra në kuadër të proceseve integruese.
- Forcimi i urave të bashkëpunimit ndër-institucional me organet ligjzbatuese, si një element i domosdoshëm në drejtim të garantimit të sigurisë dhe efektivitetit të

kontrolleve dhe hetimeve administrative, për ruajtjen e standarteve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.

- Vazhdimi i ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile, në respektim të mekanizmave informues ligjorë e publikë, në kuadër të ligjit për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale.

**ANEKSI NR. 1**

Në kuadër të zbatimit të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, si dhe Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 134/2018, datë 20.12.2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, për çështjet e përfshira në planin e veprimit, për të cilat është kërkuar raportim në një aneks të veçantë të Raportit Vjetor, Inspektorati i Lartë parashtron sa më poshtë vijon:

**A- Niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga ekzekutivi gjatë periudhës së raportimit.**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatim të kuadrit ligjor, Ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar ka në kompetencë të tij, sanksionimin me anë të masave administrative “gjobë” për shkelje të konstatuara të dispozitave ligjore, nga subjektet deklaruese apo Njësitë/Autoritetet Përgjegjëse.

Për të gjitha masat administrative “gjobë”, Inspektorati i Lartë ka ndjekur rrugët ligjore për të garantuar vënien e tyre në ekzekutim vullnetar ose të detyrueshëm nga ana e subjekteve të sanksionuara.

**B- Pasqyrat financiare, audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm, statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale, plani i veprimit të institucionit, raport ose informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe efikasitetit të rritjes së kapaciteteve njerëzore në funksion të misionit të institucionit.**

- **Audit i brendshëm dhe/ose i jashtëm.**

Në strukturën e ILDKPKI nuk ka njësi të auditit të brendshëm. Për vitin 2021, ILDKPKI nuk ka qenë e përfshirë në planin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe në planin e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Megjithatë, për vitin 2021, në zbatim të nenit 9, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, është kryer vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku është përcaktuar përgjegjshmëria menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin në institucion, duke arritur objektivat e përcaktuara dhe shmangur shpërdorimin dhe keqpërdorimin e pasurisë.

- **Plani i veprimit të institucionit.**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, mbështet planin e veprimit të institucionit në zbatim të skemës së kontrollit të deklaratave të interesave privatë, përcaktuar nga neni 25/1, i Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, duke kryer kontrollet e deklaratave të interesave privatë të subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

Gjithashtu, në kuadër të reformës në drejtësi, në zbatim të Ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar si dhe nenit 3/1 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, institucioni do të vazhdojë të jetë i angazhuar në verifikimin dhe hetimin e deklaratave të pasurive të kandidatëve për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë.

Në objektivat institucionale të Inspektoratit të Lartë për vitin në vijim, mbetet vënia në funksionim, në mënyrë efektive, e sistemit të deklarimit elektronik, si dhe forcimi i bashkëpunimit me Autoritetet Përgjegjëse dhe Njësitë Përgjegjëse, në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive...”* i ndryshuar, Ligjit



nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave...” i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar.

- **Pasqyrat financiare.**

**TABELA E BUXHETIT DHE REALIZIMI**

Llog Ek	Përshkrimi	Plan-Buxheti vjetor i rishikuar 2021	Buxheti I realizuar viti 2021	Realizimi në % viti 2021
600	Fond Page	102.860,00	98.085,49	95,36%
601	Kontrib.Sig Shoq & Shend	15.400,00	14.638,91	95,06%
602	Shpenzime operative	35.100,00	33.442,16	95,28%
606	Transferita per financime te tjera	739,52	589,52	79,72%
231	Investime	3.000,00	2.667,00	88,90%
<b>Shuma</b>		<b>157.099,52</b>	<b>149.423,07</b>	<b>95,11%</b>

- **Statusi i ankimeve gjyqësore, kallëzimet penale.**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, gjatë vitit raportues, ka aplikuar gjithsej **130 sanksione** administrative me “gjobë”, për mosdeklarim të interesave privatë, konfliktit të interesave, si dhe për shkelje të Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar. Nga këto, janë ankimuar pranë organeve gjyqësore vetëm **33 vendime**, prej të cilave, deri në momentin e raportimit, gjykata ka vendosur në mbështetje të vendimeve të marra nga ILDKPKI, **për 16 vendime**.

Njëkohësisht janë marrë masa nëpërmjet organeve përmbartimore për vënien në ekzekutim të vendimeve, lidhur me sanksionet administrative “gjobë”, ku për vitin raportues rezulton të jenë vënë në ekzekutim 43 vendime, prej të cilave, 21 vendime i përkasin sanksioneve të vendosura përgjatë vitit 2021. Për t’u theksuar është fakti se në 42 raste, shlyerja e detyrimit është kryer në mënyrë vullnetare nga subjektet e sanksionuara.

- **Informacion mbi zbatimin e ligjit të shërbimit civil dhe eficiencës së rritjes së kapaciteteve njerëzore, në funksion të misionit të institucionit.**

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, ka përmbushur detyrimet që burojnë nga Ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar

dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe Kodit të Punës për punonjësit mbështetës. Nëpërmjet Njesisë Përgjegjëse janë mbikëqyrur dhe menaxhuar burimet njerëzore, duke respektuar parimet kryesore të këtij legjislacioni, si dhe janë kryer vlerësimet e rezultateve në punë të punonjësve dhe procesi i vlerësimit të performancës së tyre, në përputhje me afatet ligjore brenda periudhës 6 mujore.

Për vitin 2021, janë kryer procedura rekrutimi, në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij, për pozicionet vakante, për 1 vend për pozicione në kategorinë e ulët drejtuese, për 2 vende për pozicione në kategorinë e mesme drejtuese, si dhe 5 vende për pozicione në kategorinë e lartë drejtuese, në ILDKPKI.

**C- Zbatimi i masave specifike të dala nga rekomandimet e instrumentave ndërkombëtarë, ku Shqipëria është shtet anëtar dhe të raporteve të Komisionit Evropian.**

Inspektorati i Lartë, gjatë periudhës raportuese ka vijuar aktivitetin institucional duke pasur në fokus rekomandimet e drejtuara Republikës së Shqipërisë nga GRECO, në Raundin e Pestë të Vlerësimit për Shqipërinë që trajton: “Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në pushtetin qendror (funksione të larta ekzekutivi) dhe në agjenci ligjzbatuese”.

Përmbushja e Rekomandimeve të GRECO V ka qenë pjesë edhe e rekomandimeve të lëna nga Komisioni Evropian në Raportin për Shqipërinë, të publikuar në tetor 2021, ku në pjesën e luftës kundër korrupsionit për institucionet rekomandohet: “ Të adresojë në mënyrë efektive rekomandimet e GRECO-s dhe të zbatojë planin e veprimit ....”.

Në Raportin e Vlerësimit të Raundit të Pestë për Shqipërinë, të miratuar nga GRECO, për rekomandimet që kishin të bënin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e ILDKPKI, GRECO rekomandoi:

Rekomandimi X: *“Të bëhet funksionale sa më shpejt të jetë e mundur platforma elektronike e krijuar për deklarimin dhe publikimin e deklarimeve të pasurisë dhe interesit”.*

Në lidhje me këtë rekomandim, gjatë vitit 2021, ILDKPKI mori të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar përmbushjen e tij në mënyrë të plotë. Konkretisht, në planin e masave të hartuar, u mundësua pilotimi i sistemit në disa institucione, me qëllim zgjidhjen e problemeve teknike që mund të ndodhnin, ndërkohë që sistemi do të ishte funksional. Gjatë kësaj periudhe të gjitha çështjet teknike të dala gjatë pilotimit u trajtuan në bashkëpunim me kompaninë përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemit.

Për më tepër, në zbatim të dispozitave ligjore, të parashikuara në nenet 4/2, 21 dhe 42/2 të Ligjit nr. 9049/2003 *“Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës, Inspektorati i Lartë hartoi dhe miratoi aktet e nevojshme nënligjore dhe formularët e deklarimit për sistemin elektronik. Kështu, Inspektori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 925 dhe Urdhrin nr. 926, datë 29.10.2021, miratoi përkatësisht formularët e deklarimit të interesave privatë në sistemin elektronik EACIDS. Njëkohësisht, u hartua dhe miratua, Udhëzimi i Inspektorit të Përgjithshëm, nr. 927, datë 1.11.2021 *“Për mënyrën dhe procedurën e plotësimit të deklaratave të pasurisë dhe interesave privatë në formë elektronike në sistemin elektronik për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesave”*, në të cilin janë përcaktuar të drejtat dhe detyrat e subjekteve të përfshirë në procesin e deklarimit elektronik. Në zbatim të këtij akti nënligjor, të gjitha subjektet deklaruese do të fillojnë të deklarojnë përmes sistemit elektronik EACIDS, duke filluar nga data 1 janar 2022. Udhëzimet dhe manualët për plotësimin e këtyre formateve janë publikuar në faqen zyrtare të ILDKPKI, në seksionin e dedikuar për sistemin e deklarimit elektronik EACIDS.

Gjithashtu, Inspektorati i Lartë, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Evropës gjatë muajve tetor - dhjetor 2021 zhvilloi aktivitete trajnuese për autoritetet përgjegjëse pranë institucioneve publike, ku u trajnuan 282 përfaqësues të autoriteteve përgjegjëse. Trajnimet e zhvilluara kishin për synim të rrisnin kapacitetet e përfaqësuesve të autoriteteve publike që janë përgjegjës për menaxhimin e procesit të deklarimit të interesave privatë nga secili deklarues dhe personat e lidhur. Këto aktivitete shërbyen gjithashtu për t'i prezantuar pjesëmarrëse sistemin elektronik dhe modulet kryesore të tij, si dhe për të ofruar informacione teknike me

synim lehtësimin e procesit të deklarimit përmes sistemit elektronik të deklaratave të pasurisë dhe konfliktit të interesit.

Rekomandimi XI: *“Të sigurohen burimet e nevojshme ligjore, njerëzore, financiare dhe burime të tjera në mënyrë që ILDKPKI të përmirësojë kapacitetin e tij për të kryer verifikimin efikas të deklarimeve të pasurive dhe interesave privatë”.*

Në lidhje me këtë rekomandim, përgjatë vitit raportues, Inspektorati i Lartë ka qenë i angazhuar për të organizuar, si dhe për të marrë pjesë në një sërë aktiviteteve trajnuese në bashkëpunim me partnerët kryesorë ndërkombëtarë.

Kështu, institucioni u angazhua për të marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, në bashkëpunim me PAMECA V, mbi veprat penale në fushën e pastrimit të Parave dhe Hetimin Financiar, si dhe veprat penale të lidhura me detyrën.

Gjithashtu, u organizuan, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, në kuadër të Programit Mbështetja Horizontale II, sesione trajnuese për verifikimin dhe hetimin e deklaratave të interesave privatë, me një këndvështrim krahasues me praktikën më të mira evropiane dhe ndërkombëtare. Për më tepër, në bashkëpunim me GIZ, u organizua dhe u zhvillua sesion trajnues mbi praktikën më të mira për hetimin dhe identifikimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe veprave penale të lidhura me të. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, ILDKPKI mori pjesë në aktivitetin trajnues të organizuar nga RAI, mbi njohjen dhe shkëmbimin e eksperiencave rajonale, në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

Në mbështetjen e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare, vlen të theksohet adresimi i kërkesave të institucionit për përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për rritjen e efektivitetit të proceseve të punës. Konkretisht, mbështetja buxhetore, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me kërkesat e institucionit ka ardhur në rritje, ku për vitin 2019 Inspektoratit të Lartë i është alokuar vlera buxhetore prej 142,700,000 lekë, në vitin 2020 vlera prej 158,500,000 lekë dhe në vitin 2021 vlera prej 195,944,000 lekë.

Në lidhje me Rekomandimet XII dhe XXIV, sjellim në vëmendje se nuk janë rekomandime të cilat i adresohen në mënyrë të drejtpërdrejtë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, por janë rekomandime që kërkojnë marrjen e masave nga institucionet përkatëse, në bashkëpunim me ILDKPKI.

Kështu, për Rekomandimin XII“i) të përfundojë si një çështje me përparësi rekrutimi i stafit të prokurorisë dhe stafit teknik në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) dhe që anëtarëve të tij t'u ofrohen burime të përshtatshme njerëzore dhe teknike dhe prokurorët të marrin trajnim specializimi të lartë, dhe ii) të vendoset në mënyrë efektive bashkëpunimi i duhur me ILDKPKI për të përmirësuar në mënyrë të efektshme zbatimin e raporteve të ILDKPKI në rastin e shkeljes së ligjeve mbi konfliktin e interesave dhe deklarimit të pasurisë nga PTEF dhe punonjësit e policisë”, ILDKPKI ka marrë të gjitha masat institucionale për të kryer në kohë sa më të shkurtër verifikimin e deklaratave të interesave private për kandidatë që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e BKH, si dhe personel administrativ pranë SPAK. Për më tepër, në vijim të mbështetjes së strukturave të SPAK, mbi hetimet e nisura për zyrtarë të cilët janë subjekte të deklarimit të interesave private, ka vendosur në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm të administruar pranë Inspektoratit të Lartë për këto subjekte. Në kuadër të plotësimit të rekomandimit është hartuar dhe është drejt përfundimit „nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndër-institucional.

Në lidhje me Rekomandimin XXIV:“Të sigurohet efektiviteti i zbatimit të ligjit për sinjalizuesit, sidomos përmes trajnimit të rregullt dhe informimit të stafit të policisë për masat e mbrojtjes së sinjalizimit”, ILDKPKI ka shprehur angazhimin për të asistuar Policinë e Shtetit në aktivitetet trajnuese, që do të planifikohen dhe organizohen brenda kurrikulave të trajnimeve që ofron ky institucion për nëpunësit e policisë.

**Ju faleminderit !**